

**AKT THEMELIMI**

**DHE**

**STATUT**

**PËR KRIJIMIN SI PERSON JURIDIK TË SHOQËRISË**

**"DELICIOUS BITE " sh.p.k.**

Sot më datë 10/09/2024 përpilohet ky statut nga ortakët themelues si vijojnë:

1. Aldorian Dhimo i biri i Perikli, lindur në Elbasan më datë 19/12/1988, banues në Tiranë dhe pajisur me ID nr.181219043K madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
2. Redian Doku i biri i Vladimir, lindur në Roshnik, Berat më datë 14/02/1987, banues në Vorë, Tiranë i pajisur me ID nr.170214081R, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
3. Vaskë Xherahu i biri i Sotirag, lindur në Korçë më datë 13/04/1980, banues në Ksamil, Sarandë i pajisur me ID nr.100413205W madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar. ,  
të cilët në përputhje me ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*", krijojnë këtë shoqëri me përgjegjesi të kufizuar si vijon:

**NENI 1**

**FORMA**

Ortakët e mësipërm krijojnë këtë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin në fuqi në Shqipëri dhe me dispozitat e këtij Statuti.

**NENI 2**

**EMRI I SHOQËRISË**

Emri i shoqërisë do të jetë "Delicious Bite" sh.p.k.

**NENI 3**

**SELIA E SHOQËRISË**

Selia qendrore e shoqërisë do të jetë në qytetin e Tiranës me adresë "*Rruga e Kavajës, Kompleksi Square 21, Numri i pasurisë 1/707+4-51 ZK 8250, Tiranë*". Shoqëria ka të drejtë që me vendim

të ortakëve të shoqërisë mund të hapë degë, zyra, filiale ose përfaqësi të shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë ose jashtë vendit.

#### NENI 4

#### KOHËZGJATJA

Shoqëria do të ketë kohëzgjatje të papërcaktuar. Si datë fillestare merret data e regjistrimit të saj në Qendrën Kombtare të Biznesit.

#### NENI 5

#### OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë “Fast food dhe Pizzeri”.

#### NENI 6

#### KAPITALI THEMELTAR,

Kapitali themeltar i shoqërisë është i përbërë nga 3(tre) kuota me vlerë totale 1000 (njëmijë) lekë.

#### NENI 7

#### KONTRIBUTET

1. Ortaku themelues Aldorian Dhimo zotëron një kuotë të barabartë me 45% të kapitalit, me vlerë 450 lekë.
2. Ortaku themelues Redian Doku zotëron një kuotë të barabartë me 45% të kapitalit me vlerë 450 lekë.
3. Ortaku themelues Vaskë Xherahu zotëron një kuotë të barabartë me 10% të kapitalit me vlerë 100 lekë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para dhe në natyrë (*pasuri të luajtshme apo të paluajtshme dhe të drejta të vlerësueshme në para*).



## **NENI 8**

### **NDARJA E FITIMIT**

Fitimi i realizuar nga aktiviteti i shoqërisë i takon ortakëve themelues në masën e pjesëmarrjes së tyre në kapital, përkatësisht:

1. Ortaku themelues Aldorian Dhimo 45%;
2. Ortaku themelues Redian Doku 45%;
3. Ortaku themelues Vaskë Xherahu 10%.

## **NENI 9**

### **TRANSFERIMI I PJESËVE TË KAPITALIT THEMELTAR**

Kuotat e kapitalit të shoqërisë mund të transferohen me anë aktesh mes të gjallëve dhe me trashëgimi.

## **NENI 10**

### **ASAMBLEJA E ORTAKEVE**

Asambleja e ortakëve organizon, drejton dhe kontrollon gjithë aktivitetin e shoqërisë. Ortaku përballon humbjet e shoqërisë deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij.

## **NENI 11**

### **DREJTIMI I SHOQËRISË**

Organi më i lartë drejtues i shoqërisë do të jetë asambleja e ortakëve. Asambleja e ortakëve mbledhet si rregull dy herë në vit, si dhe sa herë që gjykohet e arsyeshme.

## **NENI 12**

### **KOMPETENCAT E ASAMBLESË SË ORTAKEVE**

1. Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;

d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjën "c"

dh) mbikëqytjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

f) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;

g) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;

h) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratoreve;

i) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

j) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

k) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

2. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat "e" dhe

"f" të pikës 1 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.

### NENI 13

#### ADMINISTRATORI

Shoqëria do të administrohet nga administratori Z. Andrea Zoga i biri i Themistokli, lindur në Tiranë më datë 28/04/1966, banues në Tiranë i pajisur me ID nr.G60428151G madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar me afat 5 vite.

### NENI 14

#### KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Administratori i shoqërisë emërohet nga asambleja e ortakëve dhe përgjigjet për zbatimin e vendimeve të asamblesë së ortakëve. Afati i emërimit në detyrë i administratorit do të jetë 5 vite. Administratori ka këto kompetenca :

- a) Të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) Të përpilojë dhe nënshkruajë kontratat dhe aktet juridike që kanë të bëjnë me veprimtarinë e shoqërisë.

- c) Të hapi llogari rrjedhëse bankare pranë bankave shqiptare ose të huaja.
- d) Të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretët.
- e) Të përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- f) Te kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- g) Të përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- h) Të kryejë regjistrimet dhe dergojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, sic parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- i) Të raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posacme me rëndësi të vecantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- j) Të bëjë gjithcka tjetër që konsideron të dobishme dhe që është në përputhje me formën e këtij Statuti e Akti Themelues si dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi, për të arritur qëllimin dhe objektin e shoqërisë.

## NENI 15

### LIBRAT E LLOGARISË

Shoqëria është e detyruar të mbajë përvec dokumentacionit kontabël që kërkon legjislacioni në fuqi edhe keto libra:

- 1- Libri i ortakëve, në të cilin shënohen emrat e plotë të ortakeve dhe kuotat që secili ka në kapitalin e themelimit.
- 2- Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve të asamblesë.
- 3- Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve të administratorit.
- 4- Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve të organit sindikal.

## NENI 16



## VITI FINANCIAR

Cdo vit financiar fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor. Përrjashtimisht viti i parë financiar mund të fillojë pas regjistrimit të shoqërisë si person juridik dhe do të përfundoj më 31 Dhjetor 2024.

### NENI 17

#### FITIMI

Fitimet neto të shoqërisë do të konsiderohen fitimet që rezultojnë pas zbritjes nga të ardhurat e të gjitha shpenzimeve që kanë lidhje me aktivitetin tregtar të shoqërisë, detyrimet fiskale, sigurimet shoqërore, dëmet, amortizimet, etj. në përputhje me legjislacionin shqiptar.

### NENI 18

#### PRISHJA E SHOQËRISË SHPËRNDARJA DHE LIKUJDIMI

1. Shoqëria priset me kalimin e afatit të caktuar në statut dhe për arsye të parashikuara në ligj. Shoqëria priset përpara afatit me vendim të asamblesë së ortakëve.
2. Rastet e pavlefshmërisë së shoqërisë ose të një akti që ndryshon statutin si dhe bashkimi dhe ndarja e shoqërisë bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit.
3. Kur shoqëria priset, ajo kalon në likuidim dhe në këtë rast emërtimit të shoqërisë i shtohet shënimi "*Shoqëri në likuidim e siper*". Shoqëria edhe gjatë procesit të likuidimit vazhdon si person juridik deri në përfundimin e procesit të likuidimit. Prishja e shoqërisë është me pasojë ndaj të tretëve vetëm pas publikimit të prishjes në regjistrin tregtar.
4. Kur shoqëria likujdohet, pasuritë që janë venë në dispozicion të shoqërisë me të drejtë shfrytëzimi, u kthehen pronarëve.

Mjetet financiare të fituara si rezultat i veprimtarisë së shoqërisë dhe fondet fillestare ndahen ndërmjet ortakëve në përpjestim me kuotat e vëna pasi të jenë likuiduar kreditorët.

### NENI 19

#### DISPOZITA TË FUNDIT

Shoqëria ka të drejtë të punësojë punonjës që i nevojiten për të ushtruar veprimtarinë e saj. Punësimi bëhet sipas kushteve të përcaktuara në legjislacionin e punës së Republikës së Shqipërisë, si dhe rregullave të vëna në kontratën e vecantë të punësimit që lidhet midis punëdhënësit e punëmarrësit.



Të gjitha problemet që do të lindin gjatë ushtrimit të veprimtarisë tregtare të kësaj shoqërie do të zgjidhen sipas rregullave të percaktuara në statut dhe në legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Kur mosmarrëveshjet nuk zgjidhen me mirëkuptim, kompetente për zgjidhjen e tyre është Gjykata e shkallës së parë Tiranë.

## NENI 20

Ky statut firmoset me vullnetin e lire të ortakëve themelues.

### ORTAKËT THEMELUES

Aldorian Dhimo

Aldorian Dhimo  


Redian Doku

REDIAN DOKU  


Vaskë Xherahu

Vaska Xherahu  


